



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 13 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit

Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 dhe 5 nëntor 2020 (sipas rastit),² pas konfirmimit të aktakuzës,³ Kadri Veseli ("z. Veseli"), Rexhep Selimi ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqi ("z. Krasniqi") (bashkërisht, "të akuzuarit") u arrestuan në bazë të një vendimi dhe të fletarrestimeve të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴
2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesat për lirim të përkohshëm të parashtruara në emër të të akuzuarve.⁵

¹KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Jakup Krasniqit sipas Rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, publik; F00049, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Rexhep Selimit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00050, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u lëshuan përkatësisht më 19 nëntor 2020 dhe 30 nëntor 2020, F00026/CONF/RED dhe F00026/RED); F00045/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i redaktuar më tej u lëshuan po atë ditë, F00045/A02 dhe F00045/A03).

⁴ KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 nëntor 2020, F00027/RED); F00027/A03, *Fletarrestim për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00027/A05, *Fletarrestim për Rexhep Selimin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00027/A07/COR, *Version i Korrigjuar i Fletarrestimit për Jakup Krasniqin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versionet e redaktuara publike u lëshuan më 5 nëntor 2020, F00027/A03/RED, F00027/A05/RED dhe F00027/A07/COR/RED).

⁵ KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik; F00179, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Rexhep Selimit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00179/RED); F00180, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Jakup Krasniqit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00180/RED).

3. Më 25 qershor 2021 dhe 2 korrik 2021 (sipas rastit), Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarve.⁶
4. Më 1 tetor 2021, Gjykata e Apelit nxori vendimet mbi apelet e të akuzuarve kundër vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datave 25 qershor 2021 dhe 2 korrik 2021, me të cilat u urdhërua vazhdimi i paraburgimit të tyre.⁷ Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ia ktheu këto vendime Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm, për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës mund të sigurojë zbatimin e efektshëm të kushteve të propozuara nga të akuzuarit, ose të çfarëdo kushti tjetër që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e vlerëson të domosdoshëm për zvogëlimin e rreziqeve të identifikuar.⁸
5. Më 8 tetor 2021, pa cenuar asnjë vendim që mund të marrë në lidhje me vendimet e kthyerë për rishikim nga Gjykata e Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Policinë e Kosovës të dorëzonte informacion në lidhje me: (i) autoritetin dhe kapacitetin e Policisë së Kosovës për të kufizuar lëvizjet e individëve që janë subjekt i lirimit me kusht, për të monitoruar dhe kufizuar komunikimet e këtyre individëve, për të administruar arrest shtëpiak, si dhe zbatueshmërinë e kushteve që shoqërojnë lirimin e përkohshëm; dhe (ii) raste të

⁶ KSC-BC-2020-06, F00371, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 25 qershor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 qershor 2021, F00371/RED); F00372, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 25 qershor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 qershor 2021, F00372/RED); F00380, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit*, 2 korrik 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F00380/RED).

⁷ KSC-BC-2020-06, IA006/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Apelit të Krasniqit"), 1 tetor 2021, konfidencial; IA007/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Apelit të Selimit"), 1 tetor 2021, konfidencial; IA008/F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Apelit të Veselit"), 1 tetor 2021, konfidencial (versionet e redaktuara publike u lëshuan po atë ditë, IA006/F00005/RED, IA007/F00005/RED, IA008/F00004/RED).

⁸ Vendimi i Apelit të Krasniqit, para. 56-58; Vendimi i Apelit të Selimit, para. 56-58; Vendimi i Apelit të Veselit, para. 51-53.

mëparshme të zbatimit të kushteve që shoqërojnë lirimin e përkohshëm ose paraburgimin e personave të akuzuar për krime të rënda.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit, kur është e nevojshme, me kërkesë të palës apo mbrojtësit të viktimave ose me nismën e vet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të nxjerrë çfarëdo urdhri tjetër që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë.

III. DISKUTIM

7. Duke mbajtur parasysh vendimet e lartpërmendura të Gjykatës së Apelit dhe informacionin që do të dorëzojë Policia e Kosovës, si edhe pa cenuar asnjë vendim që mund të marrë në lidhje me vendimet e kthyer për rishikim nga Gjykata e Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të nevojshme të urdhërojë Administratoren të dorëzojë parashtrime në lidhje me:

(i) vlerësimin dhe qasjen për përmbushjen e synimeve legjitime lidhur me kufizimet mbi vizitat dhe komunikimet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, si garantimi i sigurisë ose rregullit në objektin e paraburgimit, parandalimi i trazirave ose kryerjes së krimeve, mbrojtja e shëndetit ose mbrojtja e mirëqenies, sigurisë, të drejtave ose lirive të tjerëve (konkretisht të dëshmitarëve dhe viktimave), në përputhje me nenin 4(2) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve;

⁹ KSC-BC-2020-06, F00513, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Drejtuar Policisë së Kosovës për Dorëzim Informacioni*, 8 tetor 2021, publik, me një shtojcë konfidenciale.

- (ii) të gjitha kufizimet e zbatueshme, përfshirë sistemin e monitorimit, lidhur me vizitat, bisedat telefonike dhe letërkëmbimet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara;
- (iii) kufizimet shtesë që mund të zbatohen për vizitat, bisedat telefonike dhe letërkëmbimet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara duke mbajtur parasysh mjetet dhe burimet e disponueshme;
- (iv) mundësinë për zbatimin e masave urgjente të sigurisë në bazë të nenit 8 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve;
- (v) çdo aspekt tjetër të sigurisë në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara që ka ndikim te vizitat, bisedat telefonike dhe letërkëmbimet; dhe
- (vi) çdo aspekt tjetër përkatës në lidhje me regjimin e paraburgimit që ka të bëjë me të akuzuarit në objektin e paraburgimit në Dhomat e Specializuara.

IV. VENDIM

8. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

URDHËRON Administratoren të dorëzojë parashtrime në përputhje me paragrafin 7 të këtij urdhri jo më vonë se të mërkurën, 20 tetor 2021.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 13 tetor 2021

Hagë, Holandë.